

## **SYLLABUSI i lëndës: Hyrje në Psikologji**

<b>Të dhëna bazike të lëndës</b>	
Njësia akademike:	<b>Fakulteti i Edukimit</b>
Titulli i lëndës:	<b>Hyrje në psikologji</b>
Niveli:	<b>Bachelor</b>
Statusi lëndës:	<b>Obligative</b>
Viti i studimeve:	<b>Viti II<sup>të</sup></b>
Numri i orëve në javë:	<b>3+2</b>
Vlera në kredi – ECTS:	<b>7 ECTS</b>
Koha / lokacioni:	<b>E mërkurë 12:30-14:45 AV1 E enjte 8:45-11 &amp; 13:15-15:30 AV2</b>
Mësimdhënësi i lëndës: Asistentët:	<b>Dr. sc. Rrezarta Avdyli Ass.Mr. Naim Telaku</b>
Detajet kontaktuese: <b>Rrezarta Avdyli</b> (F.i Edukimi: kati i IV-zyra nr. 16) <b>Naim Telaku</b>	<a href="mailto:rrezarta.avdyli@uni-pr.edu">rrezarta.avdyli@uni-pr.edu</a>  <b>ntelaku@gmail.com</b>
<b>Përshkrimi i lëndës</b>	<p><i>Në këtë lëndë hyrëse në psikologji do të njoftohen studentët me konceptet bazë që e përkufizojnë këtë shkencë ,me fushën e studimit, teoritë themelore, me metodologjinë e saj si dhe zbatimin e psikologjisë në praktikë.</i></p> <p><i>Në përgjithësi lënda përfshinë bazat e psikologjisë së përgjithshme, njohuritë e proceseve bazike në psikologji, si dhe të atyre superiore. Përmes kesaj lënde pretendohen të qartësohen proceset e ndryshme mendore dhe sjellja e njeriut sipas gjurmimeve shkencore apo empirike.</i></p> <p><i>Ndërlidhja e informatave të ndryshme që trajtohen do të jetë tema kryesore e njohurive të përfitura e të arritura nga studentet, sepse një subjekt i këtillë i studimit kaq terësor në një periudhë kohore kaq të shkurter smund të jetë më shumë se hyrje dhe ide e përgjithshme kundrejt kësaj shkence.</i></p>
<b>Qëllimet e lëndës:</b>	<i>Arritja e njohurive të përgjithshme në fund të semestrit:</i>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>○ Mbi konceptine psikologjisë si shkencë në vetë, por e ndërlidhur me shumë diciplina tjera.</li> <li>○ Te njihen proceset kognitive apo te menduarit në raport me sjelljen e nje individi apo grupi.</li> <li>○ Të zhvillohet reflektimi personal dhe mendimi kritik mbi komplikueshmerin e proceseve psikike dhe jetës psikike në përgjithësi.</li> <li>○ Të krijojme kureshtje për kte shkencë si shkencë eksperimentale e cila lejon të falsifikohen dhe te verifikohen hipoteza mbi sjelljen dhe te menduarit.</li> </ul>
<b>Rezultatet e pritura të nxënies:</b>	<p><i>Pas përfundimit të kësaj lënde studenti do të jetë në gjendje që të:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>○ Njohë faktet, teoritë dhe hulumtimet themelore në fushën e studimit të psikologjisë</li> <li>○ Njohë metodologjinë hulumtuese shkencore të përdorur nga psikologët, dhe të analizojë përparësitë dhe mangësitë e këtyre metodave përkitazi me zhvillimin e psikologjisë si shkencë.</li> <li>○ Njohë motivet, personalitetin, ndërveprimet sociale dhe forcat biologjike që ndikojnë në sjellje</li> <li>○ Njohë proceset e involvuara në të mësuarit dhe të menduarit</li> </ul>

**Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)**

<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë/javë</b>	<b>Gjithësej</b>
Ligjërata	3	15 javë	45
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15 javë	30
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	5 ditë	5
Ushtrime në teren			
Kollokfiume,seminare			
Detyra të shtëpisë	1	10 ditë	10
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	3	10 ditë	30
Përgaditja përfundimtare për provim	30		30
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	4	4 ditë	16
Projektet,prezentimet ,etj	3	3 ditë	9
<b>Totali</b>			<b>175</b>

<b>Metodologjia e mësimëdhënies:</b>	<p><i>Korniza teorike mbi konceptet e psikologjisë, proceseve psikike në përgjithësi si dhe zhvillimi i tyre do të arrihet përmes ligjërimit formal. Këto njohuri do të zgjerohen e qartësohen pastaj edhe në orët e praktikave/ ushtrimeve, duke pasur mundësinë edhe të shofin funksionimin e disa proceseve bazike në mënyre të drejtpërdrejt.</i></p> <p><i>Studentët ftohen të jenë aktiv me qëllim që të përgaditen për procesin e mësimin dhe të zhvillimit të aftësive përkatëse përmes:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Vlerësimin në mënyrë kritike të njohurive që kanë dhe debatimin në ushtrimet dhe klasë.</i></li> <li>• <i>Kthimit të komenteve dhe diskutimit për punimin e prezantuar në klasë qoftë në mënyre individuale apo grupe.</i></li> </ul>		
<b>Metodat e vlerësimit:</b>	<p><i>Për paraqitjen në provim është e domosdoshme të keni vijuar në ushtrime 80% prej tyre. Prandaj, studentet të cilet i nënshtrohen vetëm testit, nuk mund të arrijnë më shumë se 8 në provim.</i></p> <p><i>Provimi objektiv- tipit test <b>80%</b></i>  <i>Provimi është test me 3 alternativa apo zgeidhje. Për të kontrolluar rastësimin e përgjigjeve Testi do të ketë minus pikë, çka domëthënë se, nga përgjigjet e dhëna për çdo dy pikë të gabuara hiqet një e qelluar.</i></p> <p><i>Vijueshmëria në praktika / Ushtime <b>10%</b></i>  <i>Prezantimi i punimit individual apo grupor <b>10%</b></i></p> <p><i>Nota përfundimtare është shuma e këtyre përqindjeve</i></p>		
<b>Literatura</b>			
<b>Literatura bazë:</b>	<p><i>Psikologjia, Ylli Zhurda, Tiranë, 2009.</i>  <i>Psikologjia shkencë e proceseve mendore dhe e sjelljes njerzore"- Morris, CH.G. &amp; Maisto, A.A.</i>  <i>"Psikologjia - Një hyrje koncize- Terry F. Pettijohn., Tiranë,1996.</i>  <i>" Introduction to Psychology" Stangor,Ch (2011).E-book.</i></p>		
<b>Literatura shtesë:</b>	<p><i>Kaptina nga Psikologjia, Neki Juniku, Shkup, 1994</i>  <i>Psikologji e Përgjithshme, Pajazit Nushi, Prishtinë 2002.</i></p>		

<b>Java</b>	<b>Ligjerata që do të zhvillohet</b>
<b>Java e parë:</b>	<i>Prezentmi i lëndës</i>
<b>Java e dytë:</b>	<i>Tema 1. Hyrje në Psikologji: ndërlidhja dhe ndikimi me shkenca tjera</i>
<b>Java e tretë:</b>	<i>Tema 2. Teoritë dhe shkollat e ndryshme të Psikologjisë</i>
<b>Java e katërt:</b>	<i>Tema 3. Metodatat e hulumtimit në Psikologji</i>
<b>Java e pestë:</b>	<i>Tema 4. Bazat biologjike të sjelljes</i>
<b>Java e gjashtë:</b>	<i>Tema 5. Ndiçimet dhe Perceptimet</i>
<b>Java e shtatë:</b>	<i>Tema 6. Vëmendja</i>
<b>Java e tetë:</b>	<i>Tema 7. Të mësuarit</i>
<b>Java e nëntë:</b>	<i>Tema 8. Të mënduarit</i>
<b>Java e dhjetë:</b>	<i>Tema 8. Kujtesa</i>
<b>Java e njëmbëdhjetë:</b>	<i>Tema 9. Zhvillimi gjatë gjithë jetes</i>
<b>Java e dymbëdhjetë:</b>	<i>Tema 10. Emocioni dhe Motivacioni</i>
<b>Java e trembëdhjetë:</b>	<i>Tema 10. Gjendjete ndryshura të vetëdijës</i>
<b>Java e katërmëdhjetë:</b>	<i>Tema 11. Presonaliteti</i>
<b>Java e pesëmbëdhjetë:</b>	<i>Riperseritje e lëndës apo rikapitullim</i>

<b>Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:</b>
<p><b>Cakto politikat e mirësjelljes konfor statusit të UP-së.</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Studentët janë të obliguar të jenë të pranishëm në të gjitha ligjeratat dhe ushtrimet. Studentët janë të obliguar të respektojnë kohën e fillimit të ligjeratave dhe shkyqjen e telefonave mobil.</li> <li>• Secila mungesë e paarsyeshme do të mirret parasysh, dhe nëse studenti ka më shumë se tri mungesa do të ndikojnë në vlerësim dhe nuk do të ketë të drejtë të merr pjesë në provim.</li> <li>• Studentët inkurajohen të participojnë në ushtrime duke shtruar pyetje, përgjigjur në pyetje, duke dhënë ide, mendime, komente dhe duke kontribuar në mësimin e lëndës. Një pjesëmarrje e tillë pozitive dhe aktive do të rezultojë pozitivisht në notën përfundimtare.</li> <li>• Studentët do të vleresohen me provime gjysëm-semesterale, punime, prezente, seminare si dhe detyra tjera që do të jipen gjatë semestrit. Kryerja e këtyre punimeve do të shpërblehet në notën përfundimtare</li> <li>• Studentët janë të obliguar të marrin pjesë në ushtrime dhe të lexojnë kapitujt paraprakisht. Ushtrimet do të organizohen në formë të diskutimeve, punëve në grupe, si dhe seminareve. Pritet një pjesëmarrje aktive si në diskutime dhe punë grupore. Në ushtrime do të diskutohen temat e ligjëruara, si dhe do të plotësohen në ushtrime përmes artikujve të ndryshëm shkencor dhe literaturës plotësuese.</li> <li>• Studentët janë të obliguar të respektojnë kolegët gjatë punës grupore dhe diskutimeve dhe të respektojnë këndvështrimet dhe mendimet e secilit student në vete.</li> </ul>

